



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 3166 Prot.

Shkodër, më 14.09.2026

URDHËR

Nr. 114, datë 14.09.2026

"Për ndjekjen e procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në USH për vitin akademik 2026 – 2027"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM 530, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 436, datë 03.06.2020, "Për caktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimit në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e IAL-ve, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim""(i ndryshuar); Udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimit nr. 20, datë 02.10.2024 "Për ndryshimet në udhëzimin nr.12, datë 30.06.2023, të ministrit të arsimit dhe sportit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", Urdhrit të përbashkët të QSHA dhe RASH nr.108, datë 15.06.2026 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2026-2027",

URDHËROJ:

1. Të ndiqen procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, për të gjitha kategoritë e kuotave, për vitin akademik 2026-2027, nga personat përgjegjës, sipas aneksit nr.1 dhe aneksit nr.2 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Zv/Rektori akademik, Dekanët e fakulteteve, Përgjegjësit e njësive bazë, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të cilësisë, Drejtoria e IT-së, Sekretaritë mësimore, Sekretaritë e dekanëve, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Blerita DRAGUSHA



Aneksi 1.	Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve për vitin akademik 2026-2027	
Afatet dhe datat e realizimit	Pranimet në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”	Personi/at përgjegjës
	Procedura referuar Udhëzimit	Sekretaret e dekanëve
deri më 05.10.2026	Aplikimi 1. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë, të fituar pas përfundimit me sukses të studimeve përkatëse në një institucion të arsimit të lartë dhe program studimi, i cili ka qenë i licencuar përpara regjistrimit të studentit dhe me akreditim përpara lëshimit të diplomës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të kohës. 2. Për kandidatët të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të lëshuar nga IAL-të e mbyllura në zbatim të legjislationit në fuqi, data e lëshimit të diplomës duhet të ketë qenë sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore për mbylljen e tyre. Vërtetësia dhe autenticiteti i të dhënave të këtyre diplomave konfirmohet përmes vërtetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Shpallja e aplikantëve fitues (në vende të dukshme në mjediset e njësive kryesore përkatëse dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL-së) të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikanti, në përputhje me kuotat e miratuara nga IAL. Fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe në varësi të kuotave të ofruara nga programi konkret i studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi. (Ankimimi - 3 ditë) IAL-të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
deri më 09.11.2026	Regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit.	Sekretaritet mësimore Drejtoria e IT
brenda datës 13.11.2026	IAL publikon në vende të dukshme (si dhe në faqen Web të IAL-së) listën emërore të kandidatëve të regjistruar.	Dekanët e fakulteteve Sekretaritet mësimore Drejtoria e IT
21.12.2026	Dërgohen listat në QSHA për pajisje me NIM.	Dekanët e fakulteteve Sekretaritet mësimore Drejtoria e IT
30.04.2027	Për kandidatët e regjistruar me rezervë në një program studimi të arsimit të lartë të cilët kanë detyrim njohjen dhe njësimit të diplomës përkatëse, IAL-të përcjellin në QSHA brenda datës 30 prill të çdo viti akademik, dokumentet e njohjes dhe njësimit të diplomave të tyre, lëshuar nga QSHA. QSHA i pajis me NIM përpara fillimit të sezonit të dytë të provimeve. Për të gjithë kandidatët e përcjellë pas këtyre afateve apo që nuk plotësojnë kriteret sipas legjislationit në fuqi, QSHA nuk do të procedojë me dhënien e numrave të matricullimit.	Dekanët e fakulteteve Sekretaritet mësimore

Afatet dhe datat e realizimit	Transferimet dhe programet e dyta të studimit (cikli i dytë i studimeve)	
	Procedura referuar Udhëzimit	Personi/at përgjegjës
deri më 05.10.2026	Aplikimi 1. Kandidati duhet të zotërojë diplomë të ciklit të parë, të fituar pas përfundimit me sukses të studimeve përkatëse në një institucion të arsimit të lartë dhe program studimi, i cili ka qenë i licencuar përpara regjistrimit të studentit dhe me akreditim përpara lëshimit të diplomës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi të kohës. 2. Për kandidatët të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të lëshuar nga IAL-të e mbyllura në zbatim të legjislationit në fuqi, data e lëshimit të diplomës duhet të ketë qenë sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore për mbylljen e tyre. Vërtetësia dhe autenticiteti i të dhënave të këtyre diplomave konfirmohet përmes vërtetimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.	Sekretaret e dekanëve
brenda datës 06.10.2026	Shpallja e listës së aplikantëve (në vende të dukshme në mjediset e njësive kryesore përkatëse dhe në faqen zyrtare elektronike të IAL-së) që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi.	Dekanët e fakulteteve Sekretaret e Dekanëve Drejtoria e IT
brenda datës 12.10.2026	Shqyrtimi i aplikimeve nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, i cili shpallet në ambientet e fakultetit të IAL-së, si dhe në faqen elektronike zyrtare (web), e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b të shtojcës nr. 5 të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023.	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse
brenda datës 16.10.2026	IAL publikojnë listat e renditjes së kandidatëve. Fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe në varësi të kuotave të ofruara nga programi konkret i studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.	Drejtoria e IT
19.10.2026	IAL shpallin listat përfundimtare të renditjes në faqen zyrtare elektronike dhe në mjediset të dukshme pranë njësive kryesore përkatëse.	Dekanët e fakulteteve Komisionet përkatëse Drejtoria e IT
19.10.2026 - 23.10.2026	Regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit.	Sekretaritet mësimore Drejtoria e IT
brenda datës 30.10.2026	Plotësimi i kuotave të paplotësuara (ulja e vijës). Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara pas vijës së kuqe.	Sekretaritet mësimore
21.12.2026	Dërgohen listat në QSHA për pajisje me NIM.	Dekanët e fakulteteve Sekretaritet mësimore Drejtoria e IT

Aneksi nr. 2

Aplikimet bëhen për të gjitha kategoritë e kuotave, pranë Sekretarisë së Dekanit të Fakultetit që mbulon programin e studimit deri me datë **05 Tetor 2026**.

1. Kandidati/ja paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
 - ✓ Diplomë dhe listën e notave/suplementin e diplomës të njehsuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve;
 - ✓ Diplomë e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave të njehsuar me origjinalin;
 - ✓ Formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2 (të Udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023); (plotësimi bëhet në prani të punonjësit të sekretarisë)
 - ✓ Deklaratën e shtojcës nr. 1;
 - ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë);
 - ✓ 2 fotografi personale (formati për dokumente);
 - ✓ Në regjistrim përfundimtar, dorëzon mandatin e pagesës së tarifës së regjistrimit (2500 lekë pranë Zyrave të Postës Shqiptare)

Për diplomat e fituara jashtë vendit, kandidatët që nuk kanë përfunduar procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin që kanë aplikuar pranë QSHA për njohje dhe njehsim diplome.

2. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Për t’u pranuar, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj në nivelin B1.

Kandidatët të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës së huaj deri në momentin e aplikimit, kanë detyrimin të përmbushin këtë kriter dhe të dorëzojnë dokumentacionin provues deri në shpalljen e listës së fituesve.